

Universiteti i Tetovës
Fakulteti i Shkencave Mjekësore
Cikli i tretë i Studimeve të Doktoraturës

UT - Fakulteti i Shkencave Mjekësore - Përkrahja e Punimit të Doktoraturës
VI - Qyteti i Tetovës
Nr.-Ep. 22-363/1
20-02 20 20 - vit/roq.
Tetovë - Tetovë

Fakultetit të Shkencave Mjekësore
Këshillit Mësimor Shkencor të FSHM-së
Tetovë

Në bazë të Vendimit të datës 30.12.2019 për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatës **Ermira Amzai** të miratuar nga *Këshilli-Mësimor Shkencor i Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës*, u formua Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatës **Ermira Amzai** në përbërje: Prof.dr Kastriot Haxhirexha, Prof. Dr Lutfi Zylbeari, Prof.Dr Nasir Bexheti, Prof. Dr Nevzat Elezi, Prof. Dr Nexhbedin Beadini, Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës pas shqyrtimit të kërkesës të kandidatës **Ermira Amzai** paraqet këtë:

Raport

për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatës **Ermira Amzai** me titull: *"Përcaktimi i nivelit të leptinës , interleukinës dhe statusit lipidik tek pacientët me sindrom metabolik"*.

Punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidatës **Ermira Amzai** si në aspektin strukturor po ashtu edhe në aspektin përmbajtësor dhe hulumtues-shkencor i plotëson kriteret e një punimi të mirëfilltë të doktoraturës.

Punimi i disertacionit të doktoraturës është i konceptuar në *Kapituj* dhe *Nënkapituj* dhe në kuadër të punimit janë përfshi: *156 faqe, 40 figura, 13 tabela dhe 8 grafikone*.

Punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidatës **Ermira Amzai** është i strukturuar për nga aspekti përmbajtësor dhe metodologjik në: *Hyrje, Materiali dhe metoda e punës, Qëllimi i punës, Rezultatet, Diskutimi, Përfundimi, Summary dhe Literatura*.

I. HYRJA

Tek „**Hyrja**„, kandidatja **Ermira Amzai** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke përshkruar dhe cituar literaturë përkatëse të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese.

Sindroma metabolike paraqet një kombinim të anomalive metabolike dhe antropometrike që në mënyrë të drejtëpërdrejt e shtojnë rrezikun nga paraqitja e sëmundjeve kardiovaskulare dhe diabetit tip 2.

Sindromi metabolik është bërë një problem shëndetësor mbarëbotëror, për shkak të përmasave pandemike që ai ka marrë. Sipas mjekëve, ky sindrom është mjaft problematik, sepse shkakton rrezik për sëmundjet kardiovaskulare dhe për shfaqjen e diabetit tip 2.

Leptina sekretohet kryesisht nga indi dhjamor, por edhe indet tjera si placenta, truri, vezoret, mëlçia dhe muskujt skeletor. Leptina luan rol me rëndësi në rritjen e fetusit dhe në metabolizëm, termogjenezë, rregullon fillimin e pubertetit, hematopoezën, osteogjenezën dhe funksionin reprodaktiv.

Vlerat e larta të leptinës dhe insulinës gjatë periudhave kritike të zhvillimit që në periudhën fetale sjell deri te hiperfagia, obeziteti dhe hiperinsulinemia.

Vlerat e leptinës në serum zakonisht janë proporcionale me masën e indit dhjamor, për këtë arsye shumica e personave obez konsiderohen se janë leptin rezistent, më parë se sa që të kenë mungesë të leptinës.

Koncentrimi i leptinës rritet si rezultat i marjes së tepërt të ushqimit. Vlerat e leptinës në plazmë rriten me rritjen e masës së yndyrës dhe zbresin në mënyrë rapide gjatë urisë. Leptina stimulon aktivitetin fizik, prodhimin e nxehtësisë dhe energjisë. Si një citokinë pro inflamatore ndikon në rregullimin e hematopoezës dhe limfopoezës.

II. QËLLIMI I PUNIMIT

Tek „ **Qëllimi i hulumtimit,**„ kandidatja **Ermira Amzai** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të qëllimit të punimit të disertacionit të doktoraturës duke përshkruar qëllimin esencial të fushës shkencore hulumtuese të këtij punimi.

- Ky studim ka për qëllim të hulumtojë parametrat biokimik tek grupmoshat e ndryshme njërëzore të popullatës së atakuar kryesisht pacientë me sindromë metabolike si dhe çrregullimet hormonale si rezultat i sindromit metabolik, po ashtu pacientët e përfshirë në hulumtim do të analizohen edhe në bazë të gjinisë për të parë sa është BMI tek meshkujt dhe femrat , mbipesha dhe obeziteti si patologji bashkëkohore.
- Prevalenca e BMI-së tek adoleshëntët deri në moshën 20 vjeçare sepse sindromi metabolik si dukuri fillon të shfaqet që në moshën e re tek femrat dhe meshkujt.
- Në këtë punim kemi përcjell edhe faktorët që ndikojnë në disbalancin metabolik siç është mënyra e të ushqyerit si faktor kyç ne paraqitjen e sindromit metabolik tek adoleshetët dhe adultët. Sindromi metabolik është përcjell paralel edhe më ndryshimet hormonale te pacientët duke e bërë matjen e hormonit leptin, adiponektin, rezistencën ndaj insulinës, rezistinën dhe gjithashtu edhe statusin lipidik.
- Duke parë se sindromi metabolik dy dekadat e fundit është në rritje duke përfshirë edhe mëshkujt edhe femrat, grupmoshat e reja dhe grupmoshat e vjetra do të jetë edhe qëllimi kryesor i këtij hulumtimi.
- Po ashtu një rëndësi të veçantë do ti kushtojmë edhe korelacionit në mes statusit lipidik dhe hormoneve të gjëndës tiroide, duke pasur parasysh faktin që gjatë çdo hiperlipidemi

mund të kemi edhe hipotioridizëm, ky një fakt i ndjekur dhe elaboruar edhe në këtë punim.

III. METODA E HULUMTIMIT

Tek „ **Materiali dhe metoda hulumtuese,** kandidatja **Ermira Amzai** paraqet në mënyrë decide problematikën kryesore të metodologjisë hulumtuese disertacionit të doktoraturës duke përshkruar në mënyrë të thuktë metodologjinë kryesore të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese.

- Në këtë hulumtim do të përfshihen gjithsej 500 pacientë, të ndarë në bazë të grupmoshave:
- *Grupmosha e parë : Adoleshent (60 Meshkuj dhe 40 femra);*
- *Grupmosha e dytë: 21-50 vjet (100 femra dhe 100 meshkuj);*
- *Grupmosha e tretë: 51-70 vjet (100 femra dhe 100 meshkuj).*

Nga pacientët që do të hulumtohen do të meren mostra të gjakut dhe do të analizohen edhe: statusi lipidik, TSH, FT4, Adiponektina, Leptina, rezistenca ndaj insulinës dhe Rezistina

Mostrat e përfshira në hulumtim do të analizohen për nivelin e leptinës, insulinës, glukozës , TSH, FT3 dhe FT4.

Hulumtimi do të përfshij pacientë të grupmoshave dhe gjinive të ndryshme njerëzore.

Hulumtimi do të zhvillohet me metodën kolorimetrike, spektrofotometrike dhe imunoessy fluorescent me aparaturën Vidas.

IV. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Tek „**Rezultatet,**” kandidatja **Ermira Amzai** paraqet në mënyrë tabelarësh, grafikonesh dhe figurave problematikën kryesore të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese.

Rezultatet e paraqitura nëpërmjet tabelave, grafikoneve dhe figurave janë të përpunuara me anë të metodologjisë më të sofistikuar *p value* dhe vlerave referente botërore. Këto rezultate do të japin një kontribut të çmuar për diagnostifikimin e sëmundjeve që janë të lidhura me oseoporozën dhe vitaminën D. Rezultatete fituara do të shërbejnë fushës së osteologjisë dhe të osteoporozës në veçanti.

Tek diskutimi kandidatja ka parqitur në mënyrë shumë të detajuar problematikën e fushës hulumtuese dhe ka bërë krahasimin e rezultateve me shumë autor të vendit dhe sidomos me theks të veçantë potencojmë krahasimin e vlerave të kandidatës me vlerat referente të shume autoreve botëror që merren me problematikën e kësaj fushe hulumtuese.

IV. PËRFUNDIMI

Tek „**Përfundimi,**” kandidatja **Ermira Amzai** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore dhe përfundimtare të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke dhënë rekomandimet përfundimtare dhe finale të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese.

Nëse një person ka më shumë se tre faktorë rreziku, një ndër ta është sindromi metabolik, thonë mjekët. Në praktikën e thjeshtë klinike ky sindrom diagnostikohet thjesht, duke matur perimetrin e belit, që, sipas vlerave të përcaktuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (ëHO), për femrat është mbi 85 cm dhe për meshkujt mbi 102 cm. “Nëse gjenden vlera të larta, atëherë duhet të kontrollohet trigliceritet, hiperglicemia, hipertensioni arterial, etj”, thonë mjekët.

Sipas tyre, sindromi metabolik është bërë një problem shëndetësor mbarëbotëror, për shkak të përmasave pandemike që ka marrë. Mjekët thonë se ky sindrom është mjaft problematik, sepse shkakton rrezik për sëmundjet kardiovaskulare dhe për shfaqjen e diabetit tip 2. Prevalenca e sindromit metabolik në botë llogaritet deri në 35%. Në vendet e Europës ky sindrom llogaritet në 25%, në Amerikën Latine në 24-25% dhe në Azi rreth 20%. Në vendin tonë, edhe pse mungojnë shifrat e sakta mbi këtë sindrom, mendohet se ai ka tendencë për rritje të prevalencës së tij, duke qenë se ka një prirje të tillë për obezitetet dhe mbipeshë në popullatë. Kjo, duke qenë se komponenti kryesor i këtij sindromi është obeziteti, shkak për të cilin është ndryshimi i mënyrës së jetesës dhe të Obeziteti (masa e madhe dhjamore, si rezultat i ngrënies së tepërt dhe djegies së pakët të kalorive të marra, apo depozitimi i tepër kalorike) dhe mbipeshë përbëjnë rrezik për një sërë sëmundjesh, sikurse diabet tip 2, hipertension, sëmundje ishemike të zemrës e të arterieve të trurit, sëmundje të tëmthit, disa tipa kanceri, si të mitrës, ovarëve, gjirit, zorrës, tëmthit, prostatës, mëlçisë, etj. Sipas MSH, “obeziteti dhe mbipeshë shkaktojnë probleme psiko-sociale, si nocioni i fajësisë së peshës ose realiteti social paragjykes stigmatizues për të punësuar njerëz obezë, ndërsa tek fëmijët, probleme të përparimit të ulët në mësim”. Sipas një ankete, “26% e vajzave shqiptare vuajnë emocionalisht prej mbipeshës trupore”.

V. BIBLIOGRAFIA

Tek „**Bibliografia**„ kandidatja **Ermira Amzai** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke përshkruar dhe cituar literaturë përkatëse të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese.


Tek ky punim doktore do të fokusohet në literaturën më standarde më bashkëkohore dhe në mënyrë të drejtë do të citohen referencat e punimit të doktoraturës. Këto referenca të cituara do ta plotësojnë dhe do ti japin një karakter edhe më përmbajtësorë punimit të doktoraturës sepse do tu përkasin referencave më bashkëkohore të cituara me impakt ndërkombëtar, prandaj shiqar edhe nga ky aspekt ky punim do ti plotëson të gjitha standardet bashkëkohore të një punimi të mirëfilltë të doktoraturës.

Dukë u bazuar në të dhënat disertacionit të doktoraturës, konsiderojmë se ky punim i doktoraturës do të sjellë një risi tek përcaktimi i nivelit të leptinës, interleukinës dhe statusit lipidik tek pacientët me sindrom metabolik dhe do të sjellë një risi tek problematikat e imunoglobulinave dhe sindromit metabolik prandaj kërkojë nga *Këshilli Mësimor Shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore*, që ta pranojë dhe miratojë punimin e disertacionit doktoraturës së kandidatës *Ermira Hamzai* me titull: *“Përcaktimi i nivelit të leptinës , interleukinës dhe statusit lipidik tek pacientët me sindrom metabolik”*


Tetovë më, 30.01. 2020

Anëtarët e komisionit:

Prof. Dr. Kastriot Haxhirexha




Prof. Dr. Lutfi Zylbeari



Prof. Dr. Nasir Bexheti



Prof. Dr. Nevzat Elezi



Prof. Dr. Nexhbedin Beadini

